



RÖFIX KHP BASIS

Fino Akrilike me strukturë

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Fushat e përdorimit:

Suva e sipërme me strukturë, e gatshme, shtresë-hollë, e përzierë me makineri, e disponueshme në struktura, kokërrizim dhe tone ngjyrash të ndryshme.

Suva me strukturë dekorative. Për përdorim në bazament me suva dhe fasada të termoizolimit (ETICS), për përpunim manual dhe makineri.

Karakteristikat:

- Dekorativ
- Kokërriza me madhësi të ndryshme
- Përpunim i lehtë
- Ngjitje e shkëlqyer
- Qëndrueshmëri e lartë ndaj kushteve atmosferike
- Punohet me makinë spucuese
- Për sistem izolimit termik (ETICS) dhe fasada konvencionale

Përpunimi:



Të dhëna teknike					
SAP-Art. Nr.:	2000569308	2000569309	2000569339		KHP - PK II
ERGO	41266	41268	41954	KHP-PK I	
Lloji i paketimit					
Njesi për palete	24 Nj./Pal (HR)	24 Nj./Pal (HR)	24 Nj./Pal (HR)	24 Nj./Pal (HR)	24 Nj./Pal (HR)
Sasi për njësi	25 kg/Nj.				
Ngjyra	E bardhë	E bardhë	E bardhë	me ngjyra	me ngjyra
Struktura e suvasë	V	V	R		
Kokërrizimi	0 - 1,5 mm	0 - 2 mm	0 - 2 mm		
Konsumi	ca. 2,4 kg/m ²	ca. 3 kg/m ²	ca. 2,7 kg/m ²		
Dëndësia në gjendje të papërpunuar	ca. 1.800 kg/m ³				
Përçueshmëria ndaj avujve të ujit μ	150				
Vlera e pH	8,5				
Kapaciteti termik	ca. 1 J/kg K				
Kapilariteti	< 0,1 kg/m ² h				
Certifikata e testimit	Reagimi ndaj zjarrit Euroklase B-s1, d0 sipas EN 13501				
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme				
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C				
Reaksioni ndaj zjarrit	A2-s1, d0				

SAP-Art. Nr.:	KHP - PK III
ERGO	
Lloji i paketimit	
Njesi për palete	24 Nj./Pal (HR)
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Ngjyra	me ngjyra



RÖFIX KHP BASIS

Fino Akrilike me strukturë

SAP-Art. Nr.:	KHP - PK III
Struktura e suvasë	
Kokrrizimi	
Konsumi	
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	ca. 1.800 kg/m ³
Përçueshmëria ndaj avujve të ujit μ	150
Vlera e pH	8,5
Kapaciteti termik	ca. 1 J/kg K
Kapilariteti	< 0,1 kg/m ² h
Certifikata e testimit	Reagimi ndaj zjarrit Euroklase B-s1, d0 sipas EN 13501
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C
Reaksioni ndaj zjarrit	A2-s1, d0

Baza e materialit:

- Lëndë lidhëse
- Pjese me forme të shkumezuara me EPS të ngjyrosur blu (120 kg/m³) dhe EPS të bardhe (20kg/m³).
- Pigmentet
- Aditivë

Kushtet e punimit:

Mbroni nga ngrica, temperaturat mbi 30 °C, tharja e shpejtë (rrezet e drejtpërdrejta të diellit, tharëse flokësh) dhe lagështia (shiu) derisa të thahet plotësisht. Lagështia e lartë ose kondensimi sipërfaqësor zgjasin kohën e tharjes së suvasë dhe mund të çojnë në një sipërfaqe të njollosur dhe suva përfundimtare të dëmtuar. Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C.

Bazamenti:

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blozë, kripra etj. . Rrafshuesit e sistemit të izolimit termik duhet të aplikohen në përputhje me udhëzimet e zbatueshme në trashësinë e shtresës së specifikuar dhe duhet të jenë të thatë (të paktën 7 ditë - më gjatë në mot të lagësht dhe të ftohtë). Bazamente me aftësi thithëse të ndryshme mund të çojnë në diferenca të dukshme optike të sipërfaqeve (p.sh. pjesë të ndritshme, diferenca ngjyrash, etj.). Para shtrimit të suvasë së sipërme, bazamenti duhet të jete pa ngrice dhe të rrije keshtu edhe për 7 ore të tjera Kur aplikoni fino përfundimtare në suva bazë, suva bazë duhet të lihet të thahet për të paktën 7 ditë/1 cm.

BazamentiTrajtimi paraprak:

Suva mbushëse me bazë gëlqere: Mos e përdorni në këto bazamente
Suva mbushëse me bazë gëlqere /çimento: I përshtatshëm
Suva mbushëse e lehtë: Si suva niveluese (Renostar/Renoplus)
Suva termoizoluese: Mos e përdorni në këto bazamente
Beton: Si suva niveluese (Renostar/Renoplus)
Suva e vjetër me bazë minerale e palyer: Për suva rinovuese (Renostar, Renoplus)
Suva e vjetër me bojë minerale: Për suva rinovuese (Renostar, Renoplus)
Suva e vjetër organike: Për suva rinovuese (Renostar, Renoplus)
Suva mbushëse me bazë allçije e thatë: Mos e përdorni në këto bazamente
Pllaka karton gipsi: Mos e përdorni në këto bazamente
Pllaka allçije me fibra letre (p.sh. Fermacell): Mos e përdorni në këto bazamente



RÖFIX KHP BASIS

Fino Akrilike me strukturë

Bazamenti-Trajtimi paraprak:

Trajtoni paraprakisht bazamentin, të paktën 24 orë, përpara se të aplikoni suva përfundimtare me një primer të përshtatshëm me sistemin duke përdorur një furçë ose rul me qime të gjata, të paholluar, në të gjithë sipërfaqen dhe tërësisht. Shtresat e bojrave të vjetra të cara dhe të dala ngjyrë duhen larguar mekanikisht. Trajtoni sipërfaqet e ashpra me një astar të përshtatshëm penetrues. Disnivelet në bazamentin e suvasë duhet të rrafshohen/niveloohen në mënyrë profesionale paraprakisht me mbushës të përshtatshëm.

Përgatitja:

Produkt i gatshëm për përdorim
Nëse është e nevojshme, holloni me pak ujë deri sa të përfitoni dendësinë e dëshirueshme. Përpara aplikimit përzieni mirë prodhimin në enën e tij me një përzierës mekanik me rrotullime të ngadalëta
Gjatë përpunimit të suvasë së sipërme, masën e miksuar perziejeni shpesh për të mënjanuar krijimin e kokrrizave.

Përpunimi:

Në sipërfaqet e suvatimit të lidhura me njëra tjetrën aplikohet pa ndërprerje „e freskët mbi të freskët“
Shtrimi si suva me ferkim: shtrojeni në mënyrë të njëtrajtshme me mistri të lëmuar pa ndryshk e të pastër në madhësinë e kokrrizës.
Aplikimi me makinë kryhet i njëtrajtshëm me anë të një pajisje sprucuese të përshtatshme
Strukturimi si suva me gerryerje: silleni në formën e dëshiruar me cope gerryese të përshtatshme (stiropor etj.)
Duhet bërë kujdes që strukturimi të bëhet në kohën e duhur.
Pastrimi i rregullt veglave të punës për punimin e strukturës është shumë i rëndësishëm!
Pastroni me kujdes mjetet me ujë pas përdorimit.
Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri.
Temperatura të ulta dhe lagështia e madhe e zgjasin kohën e lidhjes. Aftësi të ndryshme thithjeje të bazamentit mund ta ndryshojë tonin e ngjyrës. Hollimet e forta dhe/ose përpunimi në mot me erë ose/dhe nën rreze të forta dielli mund çojë në një gradë më të lartë të formimit të kraterëve.
Në rast të kushteve të pafavorshme të motit, duhet të merren masat mbrojtëse të përshtatshme në sipërfaqen e fasadës që do të përpunohet ose fasadat e sapo bëra (p.sh. mbrojtja nga shiu).
Për finot me ngjyrë, duhet të përdoret një astar me ngjyrë të përshtatshme.



RÖFIX KHP BASIS

Fino Akrilike me strukturë

Këshilla:	<p>Pjesët kufizuese të ndërtesës (si dyer, dritare korniza dritarësh etj) përgjithësisht duhet të mbulohen para punimeve për të mënjeluar ndotjen ose korrozionin.</p> <p>Me një shpatull çeliku arrihet një shtrirje më e njëtrajtshme se sa me dërrasë plastike</p> <p>Për të mënjeluar ndryshime në ngjyra dhe parregullsi sipërfaqësore, mos përdoreni mjete të ndryshme për aplikim.</p> <p>Suvatë e freskëta duhet të mbrohen nga ndikimet e pafavorshme të motit si ngrica, rrezet e diellit direkte, era, shiu etj. me një rrjetë të përshtatshme mbrojtëse të fasadës derisa të thahen plotësisht.</p> <p>Temperaturat e ulëta sikurse lagështia e madhe zgjasin kohën e tharjes.</p> <p>Sipërfaqet e fasadave – qofshin me ose pa biocide për t'u mbrojtur nga rritja algave – kërkojnë kujdes të rregullt.</p> <p>Për ngjyrat e errëta dhe intensive < 25 HBW, i referohemi sistemit të fasadës SycoTec. Ju lutemi kontaktoni këshilltarin tuaj të specializuar.</p> <p>Suva e bazamentit duhet të ketë një rezistencë shtypjeje të paktën 1,5 N/mm². Mos e përdorni në sipërfaqe të lagura ose në sipërfaqe horizontale të ekspozuara ndaj ujit. Një garanci për tharje pa njolla nuk mund të jepet për shkak të kushteve të ndryshme të motit dhe objektit.</p> <p>Për shkak të përdorimit të lëndëve të para natyrore, ndryshime të vogla në ngjyrë janë të mundshme.</p> <p>Për suva me ngjyra, zonat e lidhura duhet të krijohen vetëm nga një porosi/dorëzimi. Për porosinë e përsëritura duhet të tregohet kantieri dhe koha e porosisë së parë. Materialet me shtresa mund të jenë subjekt i ndryshimeve të ngjyrave. Ju lutemi kontrolloni ngjyrën përpara aplikimit.</p> <p>Ankesat e mëvonshme nuk mund të merren parasysh.</p> <p>Agjentët atmosferikë, rrezet UV, ekspozimi nga lagështia ndryshojnë sipërfaqen me kalimin e kohës. Ndryshime të dukshme të ngjyrës janë të mundshme. Ky proces ndryshimi ndikohet nga materiali dhe kushtet e objektit.</p> <p>Kur fasada nuk është tharë ende, vesa, shiu mund të depozitohen në sipërfaqe. Efekti është i ndryshëm në varësi të intensitetit të ngjyrës i cili ndryshon. Dhe nuk ka ndikim në cilësinë e produktit. Efektet zhduken nga erozioni.</p> <p>Përmbajtja VOC sipas RL 2004/42/EC Kat. Ky produkt përmban < 10 g/l. VOC.</p>
Këshilla në rast reziku:	Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.
Magazinimi:	Ruani në dhoma të mbyllura, të freskëta, por pa ngrica dhe të mbyllura fort. Mbroni nga rrezet e diellit direkte. Magazinimi min. 24 muaj.
Këshilla të përgjithshme:	<p>Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme.</p> <p>Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkrijnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme.</p> <p>Informacioni i vetëm nuk përbën një marrëdhënie juridike apo detyrime të tjera shtesë.</p> <p>Në parim, ato nuk e përjashtojnë klientin nga kontrollimi i pavarur i produktit për përshtatshmërinë e tij për qëllimin e synuar.</p> <p>Vlerat teknike i referohen produkteve bazë. Devijimet nga karakteristikat teknike janë të mundshme për shkak të ngjyrosjes. Vlerat kryesore të dhëna janë vlera mesatare. Gjatë veshjes së sipërfaqeve që nuk janë përshkruar këtu, është e nevojshme të konsultoheni me ne. Ngjyrat mund të ndryshojnë pak kur rilyeni ose në lidhje me kartën e ngjyrave, nëse është e nevojshme, duhet të krijohet një zonë mostër në kantierin e ndërtimit. Informacioni për kohën e qëndrimit dhe pritjes vlen për kushtet laboratorike (+20°C/65% r.h.) dhe mund të ndryshojë në varësi të situatës së kantierit.</p>